



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.3

30 janar 2004

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4113 datë 13.1.2004	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	73
Dekret nr.4117 datë 19.1.2004	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	73
Vendim i KM nr.14, datë 14.1.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.351, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kuotave të ushqimit në spitalet ushtarake".....	75
Vendim i KM nr.24, datë 22.1.2004	Për veprimtarinë e Inspektoratit të Mjedisit.....	76
Vendim i KM nr.38, datë 22.1.2004	Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e bordit të këshilltarëve për zbatimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre".....	77
Vendim i KM nr.39, datë 22.1.2004	Për përbërjen, funksionimin, detyrat dhe të drejtat e Komisionit të Shërbimit Alternativ.....	79

Vendim i KM nr.48, datë 27.1.2004	Për përzgjedhjen e tenderuesit të preferuar për realizimin e kontratës koncesionare për aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza".....	80
Vendim i KM nr.49, datë 22.1.2004	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Koresë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve...	80
Udhëzim i MPÇS nr.73, datë 14.1.2004	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë".....	86
Udhëzim i MPÇS nr.74, datë 14.1. 2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.895, datë 12.4.2000 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional".....	88
Udhëzim i MPÇS nr.75, datë 14.1.2004	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë".....	89
Udhëzim i MPÇS nr.76, datë 14.1.2004	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra".....	92
	<i>Vendim i shkurtuar</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Qani Xhemali.....	95
	<i>Kërkesë</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Dashamir Leka.....	95

DEKRET
Nr. 4113, datë 13.1.2003

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Fatime Qamil Tafa | 15. Kleoniqi Ismail Ismaili |
| 2. Çlirim Elmaz Tafa | 16. Suzana Shaban Resulbegu |
| 3. Nazmir Ramazan Hima | 17. Adriatik Hajredin Kllloboshtica |
| 4. Hajrije Azbi Hima | 18. Emine Adem Vokrri |
| 5. Bledar Nazmir Hima | 19. Xhaferr Ymer Vokrri |
| 6. Mikel Nazmir Hima | 20. Shpend Xhaferr Vokrri |
| 7. Pjeri Thimaq Opari | 21. Fatmire Qazim Vokrri |
| 8. Ismail Hamid Zenelaj | 22. Rafaela Xhaferr Vokrri |
| 9. Pandeli Karlo Grosler | 23. Kreshnik Xhaferr Vokrri |
| 10. Reinhard Pandeli Grosler | 24. Fatjon Xhaferr Vokrri |
| 11. Engjëllushe Nestur Grosler | 25. Ilias Sofokli Zenkollari |
| 12. Everest Pandeli Grosler | 26. Ani Thimaq Zenkollari (Opari) |
| 13. Rollandi Anesti Furxhi | 27. Ledia Ilias Zenkollari |
| 14. Ervehe Isuf Furxhi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4117, datë 19.1.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fedra Llambi Blido
2. Nikolina Epber Weitz (Qylafi)
3. Brunilda Shpend Ahmataj
4. Renada Shpend Ahmataj
5. Meleqe Sali Garkisch (Nesajas)
6. Besa Mustafa Sokoli (Kastrati)
7. Mimoza Stavri Xharo (Qeleshi)
8. Elka Skënder Xharo
9. Julja Skënder Xharo
10. Aurela Xhafer Isufi
11. Shkëlqim Xhafer Toska
12. Bledar Genc Zajmi
13. Gjergj Etem Demaj
14. Alqi Lefter Kasneci
15. Besnik Sulejman Rama
16. Valbona Haki Dietrich (Reçi)
17. Mimoza Qamil Kajmeni
18. Enxhi Arben Kajmeni
19. Xhoi Xhevdet Arben Hajdari
20. Arta Shefqet Shehaj
21. Juna Vasil Schony (Meci)
22. Gencjan Jusuf Dashi
23. Ingrid Sotiraq Dashi (Mukeli)
24. Fatmir Ramiz Bici
25. Kreuzza Fatmir Bici
26. Albjona Fatmir Bici
27. Marsilda Fatmir Bici
28. Saviola Fatmir Bici
29. Arben Jahja Isufi
30. Herold Arben Isufi
31. Irma Burhan Isufi (Hushi)
32. Adelina Hasan Hasani
33. Sofije Refat Kanngießler (Sadikaj)
34. Bernard Islam Bllakaj
35. Rabie Harif Dosti (Hyka)
36. Sarah Ann Maksim Dosti
37. Jens Maksim Dosti
38. Evelina Nimet Trütschel (Musaraj)
39. Vigiana Agron Iljazi (Delvina)
40. Vilson Fejzi Kamberaj
41. Arlene Vilson Kamberaj
42. Jacqueline Vilson Kamberaj
43. Alfred Hasan Kapllani
44. Enie Alfred Kapllani
45. Lea Alfred Kapllani
46. Blerina Agim Kapllani (Dervishi)
47. Kreshnik Mehmet Bala
48. Irena Sheramet Sherameti
49. Altin Demir Hushta
50. Enkeleda Imran Pineti (Mezini)
51. Irena Nevruz Cwielag (Aliçkolli)
52. Mimoza Xhemal Çano (Tresa)
53. Ester Eduard Çano
54. Moxart Eduard Çano
55. Flladita Vllasi Grimm (Milaj)
56. Marko Günter Gerhard Grimm
57. Enni Günter Gerhard Grimm
58. Laert Asllan Canko
59. Zhaneta Islam Günther (Pepa)
60. Alzan Engjëll Lekaj
61. Petrit Riza Qordja
62. Anila Avdi Sulaj
63. Emira Elmas Ylli (Hasamataj)
64. Klevis Xhelal Ylli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 14, datë 14.1.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.351, DATË 28.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË USHQIMIT NË SPITALET
USHTARAKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.351, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave, kuotat financiare ditore të dietave të ndryshojnë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet vendimit.
2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1
KUOTAT FINANCIARE DITORE TË USHQIMIT PËR SPITALET USHTARAKE

Dieta normale nr.1	Kuota financiare ditore 244.9 lekë
Dieta hidrike nr.2/a	Kuota financiare ditore 232 lekë
Dieta hidrike nr.2/B-1	Kuota financiare ditore 228 lekë
Dieta hidrike nr.2/B-2	Kuota financiare ditore 12 lekë
Dieta në sëmundjet infektive nr.3	Kuota financiare ditore 226.4 lekë
Dieta e lëngët nr.4	Kuota financiare ditore 159.5 lekë
Dieta e qullët nr.5	Kuota financiare ditore 225.1 lekë
Dieta hepatopatikë në fazën akute e subakute nr.6	Kuota financiare ditore 203.8 lekë
Dieta blanda nr.7	Kuota financiare ditore 153.5 lekë
Dieta për ulcerozët hipo e normokalorike nr.8	Kuota financiare ditore 246.5 lekë
Dieta për energo-kolite nr.9	Kuota financiare ditore 204.9 lekë
Dieta pa gluten nr.11	Kuota financiare ditore 201.2 lekë
Dieta diabetike nr.12	Kuota financiare ditore 275.4 lekë
Dieta për diabetikët me diabet të ekuilibruar nr.13	Kuota financiare ditore 197.4 lekë
Dieta hiperkalorike, hiperproteinike e pasur me Ca dhe Fe nr.14	Kuota financiare ditore 332 lekë

VENDIM
Nr. 24, datë 22.1.2004

PËR VEPRIMTARINË E INSPEKTORATIT TË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati i Mjedisit e realizon kontrollin mbi mjedisin dhe mbi veprimtaritë që ndotin mjedisin nëpërmjet inspektimit mjedisor.

2. Ministri i Mjedisit për të rritur mundësitë e Inspektoratit, në përbërje të grupeve të inspektimit, autorizon në raste të veçanta specialistë për të marrë pjesë në inspektimet mjedisore.

3. Inspektorët pajisen me kartën e identitetit të inspektorit, ku përcaktohet territori në të cilin ata ushtrojnë kontrollin mjedisor.

4. Inspektimi mjedisor është veprimtari e inspektoratit dhe ka të bëjë me:

a) kontrollin e përputhshmërisë së subjekteve të kontrolluara me kërkesat e legjislacionit mjedisor;

b) monitorimin e ndikimit në mjedis të subjekteve të kontrolluara për të përcaktuar masat që duhen marrë për mbrojtjen e mjedisit.

5. Inspektimi mjedisor realizohet nëpërmjet:

a) grupeve të inspektimit, të përbëra nga jo më pak se dy inspektorë;

b) grupeve të inspektimit, të formuara në bashkëpunim me inspektorate të tjera;

c) kontrolleve të kryera nga inspektorati i vetëm.

6. Inspektimi mjedisor synon:

a) zbatimin e legjislacionit mjedisor në zonën objekt kontrolli;

b) përputhshmërinë e veprimtarisë së inspektuar me kërkesat ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore;

c) zbatimin e kërkesave të vendosura në inspektimin e mëparshëm.

7. Inspektimi mjedisor përfshin:

a) kontrollin dhe vlerësimin mjedisor të zonave ku ndodhen subjektet që do të kontrollohen;

b) monitorimin e respektimit të standardeve të cilësisë mjedisore nga veprimtaritë ndotëse;

c) vlerësimin e raporteve dhe të deklaratave të subjekteve objekt kontrolli;

ç) vlerësimin dhe verifikimin e çdo vetëmonitorimi të subjekteve, objekt kontrolli;

d) vlerësimin e veprimtarive dhe të funksioneve që kryen subjekti objekt kontrolli;

dh) kontrollin e mjedisëve, të pajisjeve dhe përshtatshmërinë e menaxhimit mjedisor, që kryen vetë subjekti;

e) kontrollin e të dhënave që mbajnë operatorët e subjekteve objekt kontrolli.

8. Inspektimet mjedisore planifikohen paraprakisht dhe kryhen në bazë të një plani të miratuar. Planet e inspektimeve mjedisore miratohen nga Ministri i Mjedisit.

9. Planet e inspektimit hartohen në mbështetje të programeve të bashkëpunimit me inspektoratet e tjera të degëve të industrisë, të shpërndarjes gjeografike të veprimtarive, të pajisura me leje mjedisore apo sipas shkallës së ndotjes, që paraqet secila veprimtari. Planet e inspektimit hartohen në nivel kombëtar dhe qarku. Planet në nivel qarku janë pjesë e planit kombëtar.

10. Planet e inspektimit bëhen publike dhe shpallen në një vend të dukshëm, në mjediset e institucionit.

11. Grupi i inspektimit dhe inspektorët gëzojnë të drejtën ligjore që të hyjnë në vendet ku do të ushtrohet kontroll dhe të marrin të dhëna për qëllime inspektimi mjedisor.

12. Gjatë kontrollit në vend të veprimtarive, grupi i inspektimit është i detyruar:

a) të ekzaminojë në shkallë të gjerë ndikimet negative, në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe me planet e programet e inspektimit mjedisor;

b) të ndihmojë për zgjerimin e njohurive dhe ndërgjegjësimin e subjekteve për kërkesat ligjore, për ndjeshmërinë mjedisore të shtetit, si dhe për ndikimet negative të veprimtarive të tyre;

c) të mbajë parasysh rreziqet dhe ndikimet mbi mjedis të instalimit të kontrolluar për vlerësimin e efektshmërisë së autorizimit, të lejes apo kërkesave për licencim dhe të vlerësojë nëse janë të nevojshme përmirësimet apo ndryshimet sipas këtyre kërkesave.

13. Pas çdo inspektimi mjedisor, grupi inspektues harton raportin e rezultateve të inspektimit, ku pasqyrohen:

a) të dhënat e inspektimit dhe evidencat e përputhshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e legjislacionit mjedisor;

b) vlerësimet dhe përfundimet për sanksionet që duhen marrë.

14. Inspektorati i Mjedisit gjatë inspektimit të subjekteve mban procesverbal në prani të përfaqësuesve të subjektit që kontrollohet.

15. Raportet e plota ose përfundimet e tyre i komunikohen zyrtarisht subjektit të kontrolluar, jo më vonë se 10 ditë nga përfundimi i inspektimit.

16. Raportet janë të hapura për publikun për një periudhë dymujore pas kryerjes së inspektimit.

17. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 38, datë 22.1.2004

**PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E BORDIT TË KËSHILLTARËVE,
PËR ZBATIMIN E KONVENTËS "PËR NDALIMIN E ZHVILLIMIT, TË PRODHIMIT,
MAGAZINIMIT DHE PËRDORIMIT TË ARMËVE KIMIKE DHE PËR SHKATËRRIMIN E
TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.9092, datë 3.7.2003 "Për zbatimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Bordit të Këshilltarëve për zbatimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre", pranë Ministrit të Mbrojtjes (autoriteti shtetëror), i cili të ketë në përbërje si anëtarë nga një përfaqësues nga:

- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Ministria e Ekonomisë;

- Ministria e Rendit Publik;
- Ministria e Mjedisit.

Përfaqësuesit e ministrive, anëtarë të Bordit të Këshilltarëve, të jenë në nivel drejtor drejtorie.

2. Ky Bord funksionon si organ kolegjal, në mbështetje të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

3. Bordi i Këshilltarëve mblidhet, si rregull, me kërkesën e autoritetit shtetëror ose të shumicës së anëtarëve të Bordit. Kur mbledhja thirret nga autoriteti shtetëror, njoftimi përmban rendin e ditës dhe materialet për të cilat kërkohet mendim, të cilat u dërgohen anëtarëve të Bordit të këshilltarëve të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

4. Bordi i Këshilltarëve i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarëve. Për shkaqe objektive, mbledhjet e Bordit të Këshilltarëve shtyhen, por jo më vonë se 15 ditë nga data e caktuar.

5. Bordi i Këshilltarëve, si një organ këshillues, ka detyrat e mëposhtme:

a) Bashkëpunon me institucionet shkencore: Universitetin e Tiranës (Fakultetin e Shkencave të Natyrës), Universitetin Politeknik, Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, shoqatat e industrisë kimike dhe me organizma e specialistë të fushës së kimisë, për asistencë teknike dhe për hartimin e politikave të ndryshme, në zbatim të Konventës.

b) Për çështje që ndikojnë në sigurinë kombëtare, i propozon autoritetit shtetëror të vërë në dijeni Kuvendin, Presidentin e Republikës dhe Kryeministrin.

c) I sugjeron dhe i rekomandon autoritetit shtetëror krijimin e grupeve të përbashkëta të punës për studimin dhe vlerësimin e problemeve teknike e shkencore në zbatim të Konventës.

ç) Shqyrton dhe jep mendim për udhëzimet e përbashkëta me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Rendit Publik dhe Ministrinë e Mjedisit.

d) I propozon autoritetit shtetëror marrjen e masave të përkohshme apo të përhershme për zbatimin e Konventës.

dh) Nxiti zhvillimin e njohurive shkencore e teknologjike në fushën e industrisë kimike, të bujqësisë, kërkimeve shkencore, mjekësisë, farmaceutikës apo për qëllime të tjera që lidhen me Konventën "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre".

e) Harton politika për zbatimin e Konventës, duke shmangur pengesat e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik dhe nxit bashkëpunimin ndërkombëtar për veprimtari kimike, që nuk ndalohen nga kjo Konventë, përfshi shkëmbimin e të dhënave teknike e shkencore në nivel ndërkombëtar dhe të pajisjeve për prodhimin dhe përdorimin e kimikateve.

6. Shpërblimi i anëtarëve të bordit të këshilltarëve për pjesëmarrje në mbledhje të jetë 5000 (pesë mijë) lekë.

7. Efektet financiare të përballohen nga buxhetet vjetore të ministrive të përfaqësuara në Bord.

8. Ngarkohen ministrinë e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 39, datë 22.1.2004

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE TË DREJTAT E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT ALTERNATIV

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Shërbimit Alternativ pranë Ministrisë së Mbrojtjes, i cili të kryesohet nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe të ketë në përbërje:

- | | |
|--|---------|
| - dy përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes | anëtarë |
| - një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale | anëtar |
| - një përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit | anëtar |
| - një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë | anëtar |
| - një përfaqësues nga Komiteti Shtetëror i Kulteve | anëtar |

2. Komisioni i Shërbimit Alternativ të funksionojë si organ kolegjal e vendimmarrës, në mbështetje të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

3. Komisioni i Shërbimit Alternativ mblidhet, si rregull, një herë në 3 muaj, sipas njoftimit të Kryetarit të Komisionit. Njoftimi përmban rendin e ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje. Ai u dërgohet anëtarëve të Komisionit të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

4. Komisioni i Shërbimit Alternativ i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarëve. Për shkaqe objektive, mbledhjet e Komisionit mund të shtyhen, por jo më vonë se 15 ditë nga data e caktuar.

5. Komisioni i Shërbimit Alternativ ka këto detyra:

a) Shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga qendrat e rekrutim-mobilizimit për kryerjen e shërbimit alternativ të shtetasit.

b) Vendos për kryerjen e shërbimit alternativ nga shtetasi që ka bërë kërkesën.

c) Vendos mospranimin e kërkesës së shtetasit për kryerjen e shërbimit alternativ dhe ia kthen praktikën qendrave të rekrutim-mobilizimit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë rast, Komisioni i Shërbimit Alternativ duhet të bëjë arsyetimin përkatës për mospranimin e kërkesës.

ç) Shqyrton ankesën e bërë me shkrim nga shtetasi për vendimin e Komisionit dhe merr vendimin përfundimtar. Shtetasi ka të drejtë ta bëjë këtë ankesë brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit.

d) Në çdo rast që e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë të dhëna të tjera nga shtetasi që ka bërë kërkesën për kryerjen e shërbimit alternativ, si dhe nga specialistë të fushave të ndryshme, që kanë lidhje me veprimtarinë dhe objektin e punës së këtij Komisioni.

6. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar dhe për sekretarin e Komisionit të Shërbimit Alternativ, të jetë 5000 (pesë mijë) lekë.

7. Efektet financiare të përballohen nga buxhetet vjetore të ministrive dhe institucioneve të përfaqësuara në Komisionin e Shërbimit Alternativ.

8. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 48, datë 27.1.2004

**PËR PËRZGJEDHJEN E TENDERUESIT TË PREFERUAR PËR REALIZIMIN E
KONTRATËS KONCESIONARE PËR AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
"NËNË TEREZA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të vendimit nr.479, datë 31.8.2000 të Këshillit të Ministrave "Për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në Aeroportin e Rinasit", i ndryshuar, të pikës 1/b "Instruksionet për tenderin" të vendimit nr.352, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit dhe të dokumentacionit të projektit për realizimin e kontratës së koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për realizimin e kontratës koncesionare për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë, si më poshtë vijon:

- Konsorciumi Airport Partners me 89,8 pikë
- Konsorciumi VAK me 75,6 pikë

2. Në mbështetje të renditjes në pikën 1, Koncorciumi Airport Partners përzgjidhet si tenderuesi i preferuar.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, me cilësinë e OSHA-së, të fillojnë negociimet për nënshkrimin e kontratës së koncesionit me tenderuesin e preferuar. Në rast se negociatat me këtë tenderues nuk përfundojnë me sukses, OSHA rezervon të drejtën të fillojë negociimet me tenderuesin e dytë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 49, datë 22.1.2004

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KORESË, PËR
NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Koresë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KORESË PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË
INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Koresë (këtu më poshtë të referuara si "Palë Kontraktuese"):

duke dëshiruar të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik ndërmjet të dy shteteve;

duke synuar të krijojnë kushte të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës Palë në territorin e Palës tjetër mbi bazën e një përfitimi të barabartë dhe reciprok;

duke njohur se nxitja dhe mbrojtja e investimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të stimulojë iniciativat e biznesit në këtë fushë,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi "investim" kupton çdo lloj pasurie të investuar nga investitorët e njëres Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe do të përfshijë në veçanti, por jo ekskluzivisht, si më poshtë:

a) pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejta të tjera të ngjashme, si hipotekat, qiratë, sigurimet e pasurisë dhe pengjet;

b) pjesëmarrjen me aksione, detyrimet e një shoqërie dhe çdo formë tjetër të pjesëmarrjes në një shoqëri ose ndërmarrje biznesi dhe të drejta apo interesa që rrjedhin prej tyre;

c) pretendimet në para apo të çdo forme tjetër në bazë të një kontrate që ka vlerë ekonomike;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale, duke përfshirë të drejtat e autorit, patentat, markat tregtare, emrat tregtarë, disenjot industriale, proceset teknike, sekretet tregtare, *know-how* dhe dëshira e mirë;

e) koncesionet e biznesit që kanë një vlerë ekonomike në bazë të ligjit apo të një kontrate, duke përfshirë koncesionet për studimin, kërkimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Çdo ndryshim në formën në të cilën pasuritë janë investuar ose riinvestuar nuk do të prekin karakterin e tyre si investim.

2. Termi "të ardhura" kupton shumat e vjela nga një investim dhe përfshin në veçanti, por jo ekskluzivisht, fitimin, dividendet, interesin, rritjen e kapitalit, shpërblime dhe të ardhura të tjera.

3. Termi "investitor" kupton personat fizikë ose juridikë të një Pale Kontraktuese, të cilët investojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

a) Termi "persona fizikë" nënkupton personat fizikë të cilët kanë shtetësinë e ish-Palës Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregullat e kësaj Pale.

b) Termi "persona juridikë" nënkupton çdo njësi, siç janë shoqëritë, institucionet publike, shoqatat, fondacionet, shoqëritë e përbashkëta, korporatat, filialet dhe çdo lloj tjetër organizimi të inkorporuar apo të krijuar ose me fjalë të tjera të organizuar në përputhje me ligjet dhe rregullat e ish-Palës Kontraktuese.

4. Termi "territor" nënkupton tërësinë tokësore dhe ujore të secilës Palë Kontraktuese, si dhe zonën ekonomike ekskluzive dhe shellfin kontinental jashtë kufijve të ujërave territoriale të secilës Palë Kontraktuese, mbi të cilat këto shtete ushtrojnë të drejtat e sovranitetit dhe juridiksionit, me qëllim shfrytëzimin, zbulimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

5. Termi "monedhë lirisht e konvertueshme" nënkupton monedhën e cila përdoret gjerësisht për të bërë pagesat për transaksionet ndërkombëtare dhe shkëmbehet lirisht në tregjet kryesore ndërkombëtare.

Neni 2

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

1. Çdo Palë Kontraktuese do të nxisë dhe do të krijojë kushte të favorshme për investitorët e Palës tjetër Kontraktuese për të bërë investime në territorin e saj dhe do t'i pranojë këto investime në përputhje me legjislacionin dhe rregullat saj.

2. Investimeve të bëra nga investitorët e njëres Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në çdo kohë, do t'u jepet një trajtim i drejtë dhe i barabartë dhe do të gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë ligjore në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Asnjëra Palë Kontraktuese nuk do të pengojë, në asnjë mënyrë, nëpërmjet masash arbitrare ose diskriminuese, operimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin ose disponimin e investimeve në territorin e saj nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Trajtimi i investimeve

1. Secila Palë Kontraktuese do t'u japë në territorin e saj, investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese, një trajtim të drejtë dhe të barabartë dhe jo më pak të favorshëm sesa ai që ajo u ka dhënë investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të vet apo sesa ai që ajo u ka dhënë investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të një shteti të tretë, cilido qoftë më i favorshëm për investitorët.

2. Secila Palë Kontraktuese do t'iu japë në territorin e saj, investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese, përsa i përket drejtimit, mirëmbajtjes, përdorimit ose disponimit të investimeve të tyre, një trajtim të drejtë dhe të barabartë dhe jo më pak të favorshëm sesa ai që ajo u ka dhënë investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido qoftë më i favorshëm për investitorët.

3. Trajtimi i dhënë në këtë nen do të konsiderohet si detyrim për një Palë Kontraktuese që të shtrijë tek investitorët e Palës tjetër Kontraktuese përfitimet e çdo trajtimi, preference apo privilegj që rezultojnë nga:

- a) ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin; apo
- b) përfshirja tashmë ose në të ardhmen në një zonë të tregtisë së lirë, bashkimi doganor, tregu të përbashkët ose në ndonjë tjetër bashkim ekonomik të ngjashëm.

Neni 4

Kompensimi për humbjet

1. Investitorëve të njëres Palë Kontraktuese, investimet e të cilëve pësojnë humbje në territorin e Palës tjetër për shkak të luftës ose një konflikti tjetër të armatosur, revolucionit, gjendjes së emergjencës kombëtare, kryengritjeve, luftës civile ose situatave të tjera të ngjashme, do t'u jepet nga Pala e fundit Kontraktuese, në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin ose formave të tjera të zgjidhjeve, një trajtim jo më pak i favorshëm sesa kjo Palë i jep investitorëve të vet ose të një shteti të tretë. Pagesat e rezultuara do të jenë lirisht të transferueshme dhe pa vonesa të pajustificueshme.

2. Pa paragjykuar paragrafin 1 të këtij neni, investitorëve të një Pale Kontraktuese, të cilët, në ndonjë nga situatat e referuara në këtë paragraf, pësojnë humbje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese që rezultojnë nga:

- a) shpronësimi i pasurisë së tyre nga forcat e veta ose autoritetet;
- b) shkatërrimi i pasurisë së tyre nga forcat e veta ose autoritetet të cilat nuk janë shkaktuar nga lufta apo që nuk ishte i nevojshëm për situatën,

do t'u jepet nga pala e fundit dëmshpërblim apo kompensim i menjëhershëm, jo më pak i favorshëm sesa ai që mund t'u jepet sipas të njëjtave rrethana një investitori të Palës tjetër Kontraktuese ose një investitori të ndonjë shteti të tretë. Pagesat e rezultuara do të jenë lirisht të transferueshme pa vonesa të pajustificueshme.

Neni 5 Shpronësimi

1. Investimet e investitorëve të një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese nuk do të shpronësohen ose nuk do të jenë subjekt i ndonjë mase tjetër që ka efekt ekuivalent me atë të shpronësimit (këtu më poshtë referuar si "shpronësim"), me përjashtim kur kërkohet për interes publik dhe kundrejt një kompensimi të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe efektiv. Shpronësimi do të kryhet mbi baza jodiskriminuese, në përputhje me procedurat ligjore.

2. Ky kompensim do të llogaritet me vlerën e tregut të investimit të shpronësuar në momentin përpara se masa e shpronësimit të kryhet ose përpara se ky shpronësim të bëhet publikisht i njohur, cilido është më i hershmi, dhe do të përfshijë interesin me kursin tregtar të zbatueshëm nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës dhe do të bëhet pa vonesë, do të jetë efektivisht i realizueshëm dhe lirisht i transferueshëm.

3. Investitorët e një Pale Kontraktuese të prekur nga shpronësimi do të kenë të drejtën e një shqyrtimi të menjëhershëm nga një autoritet juridik ose i pavarur i Palës tjetër Kontraktuese, të rastit të tyre dhe vlerësimit të investimeve të tyre në përputhje me parimet e vendosura në këtë nen.

4. Kur një Palë Kontraktuese shpronëson pasuritë e një kompanie e cila është formuar ose ndërtuar sipas ligjeve dhe rregullave të saj dhe në të cilën investitorët e Palës tjetër Kontraktuese zotërojnë aksione ose forma të tjera të pjesëmarrjes, atëherë do të zbatohen dispozitat e këtij neni.

Neni 6 Transferimet

1. Secila Palë Kontraktuese do t'u garantojë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese transferim të lirë të investimeve dhe të të ardhurave të tyre. Këto transferime do të përfshijnë në veçanti, por jo ekskluzivisht:

- a) fitimin neto, të ardhurat e kapitalit, dividendet, interesin, shpërblimet, pagesat dhe ndonjë formë tjetër të të ardhurave që rrjedhin prej investimeve;
- b) të ardhurat nga shitja ose likuidimi total apo i pjesshëm i një investimi;
- c) fondet për shlyerjen e huave në lidhje me një investim;
- d) fitimet e shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese, të cilët janë lejuar për të punuar në lidhje me investimet në territorin e saj;
- e) fondet shtesë të nevojshme për mirëmbajtjen ose zhvillimin e investimeve ekzistuese;
- f) shumat e shpenzuara për drejtimin e investimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose të një shteti të tretë;
- g) kompensimet që jepen në bazë të nenit 5 dhe 6.

2. Të gjitha transferimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në monedhë lirisht të konvertueshme, pa kufizime dhe vonesa të pajustificueshme, me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transferimit.

Neni 7 Zëvendësimi me të drejta të plota (subrogimi)

1. Nëse një Palë Kontraktuese ose agjencia e caktuar prej saj bën një pagesë tek investitorët e saj sipas një dëmshpërblimi të dhënë përsa i përket investimeve në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, Pala e fundit Kontraktuese do të njohë:

a) kalimin sipas ligjit ose transaksionit ligjor të çdo të drejte ose pretendimi prej investitorëve tek ish-Pala Kontraktuese apo agjencia e përcaktuar prej saj;

b) që ish-Pala Kontraktuese ose agjencia e caktuar prej saj është e autorizuar në sajë të së drejtës të zëvendësimit me të drejta të plota, të ushtrorë të drejtat dhe t'u paraqesë kërkesat e këtyre investitorëve.

2. Të drejtat ose kërkesat e zëvendësuara me të drejta të plota nuk do të tejkalojnë të drejtat ose kërkesat e mëparshme të investitorit.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet njëres Palë Kontraktuese dhe një investitori të Palës tjetër Kontraktuese

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet njëres Palë Kontraktuese dhe një investitori të Palës tjetër Kontraktuese, duke përfshirë shpronësimin e investimeve, për sa të jetë e mundur, palët do të përpiqen ta zgjidhin në mënyrë miqësore.

2. Dëshmipërblimet lokale sipas ligjeve dhe rregullave të një Pale Kontraktuese në territorin e së cilës janë kryer investimet do të jenë të vlefshme për investitorët e Palës tjetër Kontraktuese në bazë të një trajtimi jo më pak të favorshëm sesa ajo që u akordohet investimeve të investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido qoftë më i favorshëm për investitorët.

3. Në qoftë se mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet brenda gjashtë muajve nga data kur mosmarrëveshja është ngritur nga njëra palë, ajo do të shqyrtohet sipas kërkesës së njëres nga palët, te Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) të krijuar nga Konventa për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve midis shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, e hapur për nënshkrim në Washington D.C., në 18 mars 1965.

4. Vendimi i dhënë nga ICSID do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët në mosmarrëveshje. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër njohjen dhe zbatimin e vendimit në përputhje me legjislacionin e vendit të saj.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për sa është e mundur, do të zgjidhen me konsultime nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në qoftë se mosmarrëveshja nuk është e mundur të zgjidhet brenda gjashtë (6) muajve prej fillimit të bisedimeve, ajo do t'i nënshtrohet me kërkesën e njëres prej dy Palëve Kontraktuese, një gjykatë arbitrazhi të përkohshme, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

3. Kjo gjykatë arbitrazhi do të krijohet për çdo rast në mënyrën e mëposhtme: brenda dy (2) muajve nga data e marrjes së kërkesës për arbitrazh, çdo Palë Kontraktuese do të caktojë një anëtar të gjykatës. Këta dy gjykatës do të zgjedhin pastaj një shtetas të një shteti të tretë, i cili me aprovimin e të dyja Palëve Kontraktuese do të caktohet Kryetar i Gjykatës. Kryetari do të caktohet brenda dy (2) muajve, nga data e caktimit të dy anëtarëve të tjerë.

4. Në rast se brenda afateve të specifikuara në paragrafin (3) të këtij neni nuk janë bërë emërimet e nevojshme, atëherë secila Palë Kontraktuese, mund të ftojë Presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të bëjë këto emëime. Në rast se Presidenti është shtetas i ndonjëres prej Palëve Kontraktuese ose në qoftë se ai ndalohet të kryejë funksionet e mësipërme, zëvendëspresidenti ftohet që të bëjë emërimet. Në rast se zëvendëspresidenti gjithashtu është shtetas i njëres prej Palëve Kontraktuese ose nëse ai ndalohet të kryejë funksionet e mësipërme, anëtari më i vjetër i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili nuk është shtetas i njëres prej Palëve do të ftohet të bëjë emërimet.

5. Gjykata e arbitrazhit do t'i japë vendimet e saj me shumicë votash. Ky vendim do të jetë detyrues për të dyja Palët Kontraktuese.

6. Çdo Palë Kontraktuese do të përballojë shpenzimet për gjykatësin e zgjedhur prej saj dhe ato të përfaqësimit në procedurat e arbitrazhit. Shpenzimet e tjera përfshirë dhe ato të kryetarit, do të përballohen në pjesë të barabarta nga të dyja palët. Gjykata e arbitrazhit, mundet, megjithatë, që me vendim të saj direkt të vendosë që njërës nga të dyja Palët Kontraktuese t'i caktohet një pjesë më e lartë e shpenzimeve. Gjykata e arbitrazhit do t'i përcaktojë vetë procedurat e saj.

Neni 10

Zbatimi i rregullave të tjera

1. Kur një çështje është trajtuar në të njëjtën kohë nga kjo Marrëveshje dhe nga një marrëveshje tjetër ndërkombëtare në të cilat të dyja Palët Kontraktuese janë palë, ose nga parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar, atëherë kjo Marrëveshje nuk do të ndalojë secilën Palë Kontraktuese ose investitorët e saj, që të kenë avantazhin e shfrytëzimit të atyre rregullave të cilat janë më të favorshme për rastin e tyre.

2. Në qoftë se trajtimi që jepet nga një Palë Kontraktuese tek investitorët e Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj ose me dispozitat apo kontratat specifike është më i favorshëm sesa ai që i jepet sipas kësaj Marrëveshjeje, atëherë do të zbatohet trajtimi më i favorshëm.

3. Secila Palë Kontraktuese do të shqyrtojë çdo detyrim tjetër që mund të jetë vendosur në lidhje me investimet e bëra në territorin e saj nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 11

Zbatimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjitha investimet e bëra përpara ose mbas hyrjes në fuqi të saj, por nuk do të zbatohet tek ndonjë mosmarrëveshje lidhur me investimet të cilat janë kryer përpara hyrjes së saj në fuqi.

Neni 12

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit në të cilën Palët njoftojnë njëra-tjetrën se formalitetet kushtetuese të kërkuara për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje janë përfunduar. Ajo do të zbatohet nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe do të qëndrojë në fuqi për një periudhë fillestare prej dhjetë vjetësh dhe do të përsëritet automatikisht për një periudhë të mëtejshme prej dy vjetësh.

2. Secila Palë mund të përfundojë këtë Marrëveshje me një njoftim paraprak me shkrim në adresë të Palës tjetër, 6 muaj përpara datës së përfundimit të saj.

3. Përsa i përket investimeve të kryera para datës së përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e të gjitha neneve të tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi për një periudhë të mëtejshme prej dhjetë vjetësh nga data e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë, më 15.12.2003 në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, koreane dhe anglisht duke qenë të gjitha tekstet me fuqi të barabartë.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

UDHËZIM
Nr. 73, datë 14.1.2004

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.73, DATË 11.2.1999 “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET
FORMIMIT NË PUNË”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave datë 17.1.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë çdo punëdhënës, i cili është person juridik ose fizik dhe ushtron aktivitet ekonomik prej të paktën një viti nga data e aplikimit në këtë program.

2. Për të përfutur nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës kompetente të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik apo fizik (në vendimin e gjykatës duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkon të punësojë punëkërkesit e papunë).

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

c) Një informacion mbi:

i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;

ii) numrin e fuqisë punëtore;

iii) nivelin e pagës që ai ka dhënë për çdo person.

d) Marrëveshjen me sigurimet shoqërore për numrin e punëtorëve të siguruar.

e) Numrin e llogarisë bankare.

f) Një informacion mbi:

i) numrin e punëtorëve që kërkohen të punësohen;

ii) profesionin për të cilin do të punësohen;

iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtorë;

iv) kohëzgjatjen e punësimit;

v) llojin e kontratës që kërkon të zbatojë;

vi) nivelin e pagës.

g) Bilancin ekonomik-financiar të vitit të mëparshëm për personat juridikë. (Që të konsiderohet kërkesa e punëdhënësit, bilanci duhet të jetë pozitiv, vërtetuar kjo nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron aktivitetin.) Për personat fizikë duhet të paraqitet një vërtetim nga dega e tatim-taksave në lidhje me korrektësinë e derdhjes së detyrimeve tatimore.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punëdhënësi, në bashkëpunim me zyrën kompetente të punësimit, plotëson formularin përkatës.

3. Vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur nga punëdhënësi verifikohet në bashkëpunim me inspektorë të inspektoratit vendor dhe rajonal të punës, i cili shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e dokumentacionit dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

4. Përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi vendosen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti.

5. Zyra kompetente e punësimit mbledh, shqyrton dhe vlerëson projektet e paraqitura nga punëdhënësit. Ajo thërret mbledhjen e këshillit lokal tripalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen. Zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

a) Zyra vendore e punësimit dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit, në zyrën rajonale të punësimit ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur aplikues janë ndërmarrjet e vogla në kuptim të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” dhe dërgon për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit projektet ku aplikues janë ndërmarrjet që kanë mbi 21 të punësuar.

Sipas ligjit të sipërpërmendur, ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;

c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte të cilat, në kuptim të ligjit të sipërpërmendur, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

6. Në rastet kur aplikues janë ndërmarrje të vogla në kuptimin e numrit të punonjësve, por me përfitimin e financimit sipas këtij programi hyjnë te ndërmarrjet e mesme, aplikimi dërgohet për miratim në komisionin e ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

7. Për zbatimin e pikës 6 të këtij udhëzimi ngrihen komisionet përkatëse për miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) Në çdo zyrë rajonale punësimi ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

b) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit dhe e përbërjes së komisioneve përcaktohet me rregullore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Komisioni i zyrës rajonale të punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi. Komisioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për aplikim nga punëdhënësi.

9. Për projektet e miratuara, zyra kompetente e punësimit në bashkëpunim me punëdhënësin plotësojnë listën e punëkërkuësve të papunë që do të përfshihen në program. Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë.

10. Për efekt zbatimi të këtij vendimi, financimi bëhet duke iu referuar nivelit të pagës minimale në shkallë vendi.

11. Në zbatim të pikës 1 të vendimit, për çdo të punësuar punëdhënësi përfiton:

a) kompensim mujor për pagë në masën 100 për qind të pagës minimale;

b) kompensim mujor për sigurimet shoqërore e shëndetësore në masën 100 për qind, duke iu referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

12. Në zbatim të pikës 2 të vendimit, pas përfundimit të periudhës së formimit për çdo të punësuar mbi numrin e fiksuar në kontratë, punëdhënësi merr një shpërblim të menjëhershëm të barabartë me 100 për qind të shumës së pagës minimale në shkallë vendi dhe 100% të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për punëmarrësit për një periudhë 3-mujore.

13. Marrëdhëniet midis Shërbimit Kombëtar të Punësimit, punëdhënësit dhe punëkërkuësve të papunë të punësuar sipas këtij programi vendosen në marrëveshje të përbashkëta midis tyre. Punëdhënësi dhe punëmarrësi nënshkruajnë një marrëveshje për kushtet e punësimit të personave që punësohen. Marrëveshja përmban në çdo rast emrat e të gjithë personave që do të angazhohen në program.

14. Në zbatim të pikës 3 të vendimit, zyra kompetente e punësimit është e detyruar të cregjistrojë nga lista e punëkërkuësve të papunë personat që pa arsye të pranueshme refuzojnë të marrin pjesë në program. Procedurat përcaktohen në rregulloren e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

15. Në zbatim të pikës 4 të vendimit, zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të përfshirë në program, të cilët janë përfitues të pagesës së papunësisë.

Zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet kësaj liste fondet e kursyera nga ai program, të cilat e kalojnë masën 100 për qind të buxhetit të këtij programi. Procedurat e kalimit të fondeve përcaktohen në udhëzimin e përbashkët me Ministrin e Financave.

16. Në zbatim të pikës 5 të vendimit, zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të punësuar që janë pjesëtarë të familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike. Zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet këtij formulari sasinë e fondeve që përfiton ky program nga punësimi i tyre. Kjo sasi është 40 për qind e ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona për çdo muaj trajnim. Procedurat e kalimit të fondeve përcaktohen në udhëzimin e përbashkët me Ministrin e Financave.

17. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj informacion në lidhje me zbatimin e projekteve, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura, punëkërkesit e papunë etj.

18. Procedurat për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit dhe hollësi të tjera përcaktohen në udhëzimin e përbashkët me Ministrin e Financave.

19. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip përcaktohen me rregulloren metodike të zbatimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

20. Udhëzimi nr.368/2, datë 10.5.1999 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS DHE I ÇËSHTJEVE SOCIALE
Engjell Bejtaj

UDHËZIM
Nr. 74, datë 14.1.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.895, DATË 12.4.2000 "PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.2.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË FORMIMIT INSTITUCIONAL"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional",

UDHËZOJ:

1. Pika 1 e udhëzimit riformulohet me këtë përmbajtje:

"Në zbatim të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999, Shërbimi Kombëtar i Punësimit plotëson me punëkërkes të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit për shfrytëzimin e kapacitetit të kurseve të ofruara nga punëdhënësit, veprimtaria e të cilëve është licencuar nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe kanë të paktën 6 muaj eksperiencë në fushën e formimit profesional, kur ata garantojnë punësimin me kontratë të rregullt njëvjeçare të 20% të pjesëmarrësve në kurs."

2. Fjalja e dytë e pikës 8 dhe nënpikat e saj riformulohen me këtë përmbajtje:

"Fushat prioritare ku zbatohet programi vendosen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS DHE I ÇËSHTJEVE SOCIALE
Engjell Bejtaj

UDHËZIM
Nr. 75, datë 14.1.2004

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.69, DATË 11.2.1999 “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË
PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 17.1.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë çdo punëdhënës i cili është person juridik ose fizik dhe ushtron aktivitet ekonomik prej të paktën një viti nga data e aplikimit në këtë program.

2. Për të përfutur nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës kompetente të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik/fizik (në vendimin e gjykatës duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkon të punësojë punëkërkuesit e papunë).

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

c) Një informacion mbi:

i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;

ii) numrin e fuqisë punëtore;

iii) nivelin e pagës që ai ka dhënë për çdo person.

d) Marrëveshjen me sigurimet shoqërore për numrin e punëtorëve të siguruar.

e) Numrin e llogarisë bankare.

f) Një informacion mbi:

i) numrin e punëtorëve që kërkohen të punësohen;

ii) profesionin për të cilin do të punësohen;

iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtorë;

iv) kohëzgjatjen e punësimit;

v) llojin e kontratës që kërkon të zbatojë;

vi) nivelin e pagës.

g) Bilancin ekonomik-financiar të vitit të mëparshëm për personat juridikë. (Që të konsiderohet kërkesa e punëdhënësit, bilanci duhet të jetë pozitiv vërtetuar kjo nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron aktivitetin.) Për personat fizikë duhet të paraqitet një vërtetim nga dega e tatim-taksave në lidhje me korrektësinë e derdhjes së detyrimeve tatimore.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punëdhënësi, në bashkëpunim me zyrën kompetente të punësimit, plotëson formularin përkatës.

3. Vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur nga punëdhënësi verifikohet në bashkëpunim me inspektorë të inspektoratit vendor dhe rajonal të punës, i cili shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e dokumentacionit dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

4. Përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi vendosen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti.

5. Zyra kompetente e punësimit mbledh, shqyrton dhe vlerëson projektet e paraqitura nga punëdhënësit. Ajo thërret mbledhjen e këshillit lokal tripalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.

Zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

a) Zyra vendore e punësimit dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit, në zyrën rajonale të punësimit ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur aplikues janë ndërmarrjet e vogla në kuptim të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” dhe dërgon për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit projektet ku aplikues janë ndërmarrjet që kanë mbi 21 të punësuar.

Sipas ligjit të sipërpërmendur, ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;

c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte të cilat, në kuptim të ligjit të sipërpërmendur, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

6. Në rastet kur aplikues janë ndërmarrje të vogla në kuptimin e numrit të punonjësve, por me përfitimin e financimit sipas këtij programi hyjnë te ndërmarrjet e mesme, aplikimi dërgohet për miratim në komisionin e ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

7. Për zbatimin e pikës 6 të këtij udhëzimi ngrihen komisionet përkatëse për miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) në çdo zyrë rajonale punësimi ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit dhe e përbërjes së komisioneve përcaktohet me rregullore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Komisioni i zyrës rajonale të punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi. Komisioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për aplikim nga punëdhënësi.

9. Për projektet e miratuara, zyra kompetente e punësimit në bashkëpunim me punëdhënësin plotësojnë listën e punëkërkesve të papunë që do të përfshihen në program. Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë.

10. Për efekt zbatimi të vendimit, financimi bëhet duke iu referuar nivelit të pagës minimale në shkallë vendi.

11. Në zbatim të pikës 1 të vendimit, për çdo të punësuar punëdhënësi përfiton:

a) kompensim mujor për pagë në masën 70 për qind të pagës minimale në shkallë vendi;

b) kompensim mujor për sigurimet e detyrueshme shoqërore e shëndetësore në masën 100 për qind, duke iu referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

12. Në zbatim të pikës 2, zyra kompetente e punësimit në bashkëpunim me punëdhënësin plotëson listën e punëkërkesve të papunë që do të përfshihen në këtë program. Për efekt zbatimi të pikës 2 të vendimit:

Paragrafi 1. Punëdhënësi përfiton financim mujor të barabartë me shumën e 5 pagave minimale në shkallë vendi dhe shpenzimet për sigurime të detyrueshme për çdo të punësuar. 3 paga dhe sigurimet e detyrueshme për tre muaj financohen në tre muajt e parë të zbatimit të kontratës dhe 2 paga dhe sigurimet e detyrueshme për dy muaj në 2 muajt e fundit të zbatimit të kontratës.

Paragrafi 2. Në rastin kur punëdhënësi ka përfituar më parë sipas pikës 1 të vendimit, atëherë financimi mujor që ai përfiton është i barabartë me shumën e 3 pagave minimale në shkallë vendi dhe shpenzimet për sigurimet e detyrueshme. 2 paga dhe sigurimet e detyrueshme jepen në dy muajt e parë të zbatimit të kontratës dhe 1 pagë dhe sigurimet e detyrueshme jepen në muajin e fundit të zbatimit të kontratës.

13. Në zbatim të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999:

a) Në rast se personat e punësuar nuk kanë formimin e duhur profesional, për proceset e punës për të cilat do të punësohen (e evidentuar me formularin tip), punëdhënësi fiton 20 për qind shtesë të kompensimit për punësimin sipas pikës 1 të vendimit dhe për pikën 2 të vendimit rritje të subvencionit në masën 10 për qind.

b) Kur për ngritjen profesionale të personave të punësuar kërkohen masa të veçanta dhe shpenzime shtesë që detyrohet t'i kryejë punëdhënësi, ai në aplikimin e tij duhet të paraqesë edhe shpenzimet që do të kryhen për përgatitjen profesionale në formën e buxhetit të trajnimit.

c) Komisioni përkatës vendos për financimin e tyre, në rastet kur ai e shikon të nevojshme dhe të argumentuar.

14. Në zbatim të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 punëdhënësi përfiton shtesë të kompensimit për personat e punësuar, të cilët janë përfitues të programit të pagesës së papunësisë në masë proporcionale me numrin e muajve të pagesës së papunësisë që shkurtohen. Kontratës së nënshkruar ndërmjet zyrës kompetente të punësimit dhe punëdhënësit i bashkëngjitet lista e personave të punësuar që janë përfitues të pagesës së papunësisë dhe kompensimi mujor për pagë:

- rritet 3 për qind për çdo muaj pagesë papunësie që shkurtohet në rastin e punësimit sipas pikës 1 të vendimit;

- shtohet subvencioni në masë 25 për qind të shumës së mbetur për t'u paguar si pagesë papunësie për rastin e punësimit sipas paragrafit të parë të pikës 2 të vendimit.

Për efekt zbatimi të kësaj pike i referohemi nivelit bazë të pagesës së papunësisë.

15. Në zbatim të pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999, punëdhënësi përfiton shtesë të kompensimit për personat që janë punësuar, të cilët janë pjesëtarë të familjeve të trajtuara nga programi i ndihmës ekonomike në masë proporcionale me ndihmën ekonomike që familja ka përfituar në vitin e fundit kalendarik. Kontratës së nënshkruar ndërmjet zyrës kompetente të punësimit dhe punëdhënësit i bashkëngjitet lista e personave të punësuar që janë pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Për punësimin sipas pikës 1 të vendimit, kompensimi mujor për pagë rritet 2% për çdo muaj ndihmë ekonomike të plotë dhe 1% për çdo muaj ndihmë ekonomike të pjesëshme (në varësi të llojit të ndihmës që përfiton familja në të cilën bën pjesë i punësuar). Për personat e punësuar sipas paragrafit të parë të pikës 2 të vendimit, punëdhënësi fiton shtesë subvencioni në masën 10% të shumës së paguar për ndihmë ekonomike në vitin e fundit kalendarik.

16. Në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999, zyra kompetente e punësimit llogarit, nëpërmjet formularit të personave të punësuar që janë përfitues të pagesës së papunësisë, fondet e kursyera nga ai program, të cilat i kalojnë në masën 100% buxhetit të këtij programi. (Procedurat e kalimit të fondeve përcaktohen në udhëzimin e përbashkët me Ministrin e Financave.)

17. Në zbatim të pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999, zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet formularit të personave të papunë të punësuar pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike fondet që përfiton buxheti i programit. Për personin që punësohet sipas pikës 1 të vendimit, sasia e fondeve që transferohen është 30% e ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona për një periudhë të barabartë me kohën e punësimit. Për punësimin sipas paragrafit të parë të pikës 2 të vendimit, për çdo person që punësohet nga programi i ndihmës ekonomike transferohet një fond i barabartë me 30% të shpenzimeve që programi i ndihmës ekonomike ka bërë për familjen e personit gjatë vitit të fundit kalendarik. (Procedurat e kalimit të fondeve përcaktohen në udhëzimin e përbashkët me Ministrin e Financave.)

18. Marrëdhëniet midis Shërbimit Kombëtar të Punësimit, punëdhënësit dhe punëkërkuësve të papunë të punësuar sipas programit vendosen në marrëveshje të përbashkëta midis tyre. Punëdhënësi dhe punëmarrësi nënshkruajnë një marrëveshje për kushtet e punësimit të personave që punësohen. Marrëveshja përmban në çdo rast emrat e të gjithë personave që do të angazhohen në program.

19. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në Drejtorinë Qendrore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informacione në lidhje me projektet, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura, punëkërkesit e papunë etj.

20. Procedurat për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit dhe hollësi të tjera të përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Financave.

21. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip, përcaktohen në rregulloren metodike të zbatimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

22. Udhëzimi nr.370/2, datë 10.5.1999 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS DHE I ÇËSHTJEVE SOCIALE
Engjell Bejtaj

UDHËZIM

Nr. 76, datë 14.1.2004

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.632, DATË 18.9.2003 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papuna femra" dhe nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papuna femra çdo punëdhënës i cili është person juridik/fizik dhe ushtron aktivitet ekonomik prej të paktën një viti nga data e aplikimit në këtë program.

Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës kompetente të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik ose fizik (në vendimin e gjykatës duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkon të punësojë punëkërkesit e papunë).

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

c) Një informacion mbi:

i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;

ii) numrin e fuqisë punëtore;

iii) nivelin e pagës që ai ka dhënë për çdo person.

d) Marrëveshjen me sigurimet shoqërore për numrin e punëtorëve të siguruar.

e) Numrin e llogarisë bankare.

f) Një informacion mbi:

i) numrin e punëtorëve që kërkohen të punësohen;

ii) profesionin për të cilin do të punësohen;

iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këto punëtorë;

iv) kohëzgjatjen e punësimit;

v) llojin e kontratës që kërkon të zbatohet;

vi) nivelin e pagës.

d) Bilancin ekonomik-financiar të vitit të mëparshëm për personat juridikë. (Që të konsiderohet kërkesa e punëdhënësit, bilanci duhet të jetë pozitiv, vërtetuar kjo nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron aktivitetin.) Për personat fizikë duhet të paraqitet një vërtetim nga dega e tatim-taksave në lidhje me korrektësinë e derdhjes së detyrimeve tatimore.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punëdhënësi, në bashkëpunim me zyrën kompetente të punësimit, plotëson formularin përkatës.

3. Vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur nga punëdhënësi verifikohet në bashkëpunim me inspektorë të inspektoratit vendor dhe rajonal të punës, i cili shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e dokumentacionit dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

4. Përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi vendosen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti.

5. Zyra kompetente e punësimit mbledh, shqyrton dhe vlerëson projektet e paraqitura nga punëdhënësit. Ajo thërret mbledhjen e këshillit lokal tripalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen. Zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

a) Zyra vendore e punësimit dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit, në zyrën rajonale të punësimit ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur aplikues janë ndërmarrjet e vogla, në kuptim të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” dhe dërgon për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit projektet, ku aplikues janë ndërmarrjet që kanë mbi 21 të punësuar.

Sipas ligjit të sipërpërmendur ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;

c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte të cilat, në kuptim të ligjit të sipërpërmendur, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

6. Në rastet kur aplikues janë ndërmarrje të vogla në kuptimin e numrit të punonjësve, por me përfitimin e financimit sipas këtij programi hyjnë tek ndërmarrjet e mesme, aplikimi dërgohet për miratim në komisionin e ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

7. Për zbatimin e pikës 4 ngrihen komisionet përkatëse për miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) Në çdo zyrë rajonale punësimi ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

b) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit dhe e përbërjes së komisioneve përcaktohet me rregullore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Komisioni i zyrës rajonale të punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi. Komisioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për aplikim nga punëdhënësi.

9. Për projektet e miratuara, zyra kompetente e punësimit në bashkëpunim me punëdhënësin plotëson listën e punëkërkueseve femra të papuna. Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë ku përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë.

10. Për efekt zbatimi të këtij vendimi, financimi për sigurimet e detyrueshme bëhet proporcionalisht duke iu referuar nivelit të shpenzimeve të kontributit të punëdhënësit.

11. Për çdo të punësuar, sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave, punëdhënësi përfiton financimin mujor të barabartë me 70% të shumës së shpenzimeve të sigurimeve të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për gjithë vitin e zbatimit të kontratës.

70% të sigurimeve të detyrueshme

12. Për efekt të zbatimit të pikës 2 të vendimit, punëdhënësi përfiton financim mujor:

a) sipas pikës 10 të këtij udhëzimi, pra 70 për qind të shumës së shpenzimeve për sigurime të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për vitin e parë të zbatimit të kontratës;

b) 85 për qind të shumës së shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për çdo të punësuar, për gjithë vitin e zbatimit të kontratës. Financimi fillon në vitin e dytë të zbatimit të kontratës.

70% sigurime të detyrueshme viti i parë

85% sigurime të detyrueshme viti i dytë

13. Për efekt të zbatimit të pikës 3 të vendimit, punëdhënësi përfiton financim mujor:

a) sipas pikës 10 dhe 11 të këtij udhëzimi, pra 70% të shumës së shpenzimeve për sigurime të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për vitin e parë të zbatimit të kontratës,

85% të shumës së shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për vitin e dytë të zbatimit të kontratës, për çdo të punësuar.

b) të barabartë me 100% të shumës së shpenzimeve të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për çdo të punësuar, për vitin e tretë të zbatimit të kontratës. Financimi fillon vitin e tretë të zbatimit të kontratës.

70% sigurime të detyrueshme viti i parë

85% sigurime të detyrueshme viti i dytë

100% sigurime të detyrueshme viti i tretë

14. Në zbatim të pikës 4 të vendimit, punëdhënësit të cilët punësojnë punëkërkuese femra mbi 35 vjeç, femra rome, femra me aftësi të kufizuara, vajzat nëna, femra të divorcuara me probleme sociale:

a) (paragrafi a) Kur punësimi bëhet sipas pikës 1 të vendimit, përveç financimit sipas pikës 10 të këtij udhëzimi, përfitojnë financim 4 paga minimale në shkallë vendi gjatë vitit të parë të zbatimit të kontratës. 3 paga jepen në fillim të vitit të punës (për çdo muaj) dhe 1 pagë jepet në muajin e fundit të kontratës së punës.

70% sigurime të detyrueshme

4 paga minimale

b) (paragrafi b) Kur punësimi bëhet sipas pikës 2 të vendimit, përveç financimit sipas pikës 10 dhe 11 të këtij udhëzimi dhe paragrafit 1 të kësaj pike, përfitojnë financim 6 paga minimale në shkallë vendi. 5 paga minimale në shkallë vendi jepen në fillim të vitit të dytë të kontratës (për çdo muaj) dhe 1 pagë jepet në fund të vitit.

70% sigurime të detyrueshme për vitin e parë

85% sigurime të detyrueshme për vitin e dytë

4 paga minimale për vitin e parë

6 paga minimale për vitin e dytë

c) (paragrafi c) Kur punësimi bëhet sipas pikës 3 të vendimit, përveç financimit sipas pikës 12 të këtij udhëzimi dhe paragrafit 1 dhe 2 të kësaj pike, përfitojnë 8 paga minimale në shkallë vendi. 7 paga jepen në 7 muajt e parë të zbatimit të kontratës dhe 1 pagë jepet në muajin e fundit të zbatimit të kontratës.

70% sigurime të detyrueshme për vitin e parë

85% sigurime të detyrueshme për vitin e dytë

100% sigurime të detyrueshme për vitin e tretë

4 paga minimale për vitin e parë

6 paga minimale për vitin e dytë

8 paga minimale për vitin e tretë

15. Identifikimi i personave sipas pikës 4 bëhet si më poshtë:

- Për femrat e trafikuar, listat e tyre duhet të vijnë nga Shërbimi Social Shtetëror për ato që trajtohen në institucionet shtetërore të përkujdesit, si dhe nga OJF-të, të cilat kanë marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale;

- Për femra mbi 35 vjeç, identifikimi bëhet nga regjistrimi në zyrën kompetente të punësimit (duke e vërtetuar me një kopje të dokumentit të identifikimit të noterizuar);

- Për femrat rome të regjistruara, zyrat e punësimit duhet të bashkëpunojnë me shoqatat rome të regjistruara në gjykatë;

- Për femrat me aftësi të kufizuar, identifikimi bëhet me vërtetim të komisioneve KMCAP dhe KMPV;

- Për vajzat nëna të paraqitet certifikata nga zyra e gjendjes civile;

- Për femra, të divorcuara me probleme sociale duhet vendimi i gjykatës për zgjidhje martesë dhe një vërtetim nga njësia administrative përkatëse për gjendjen ekonomike të tyre.

16. Në zbatim të pikës 5 të vendimit, kontrolli bëhet nga inspektorët e inspektoratit rajonal dhe vendor për pikat (a), (b) dhe (c), punëdhënësi përfiton nga ky program kur nga kontrollet e bëra rezultojnë se nuk janë shkelur këto pika.

17. Me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës apo të strukturave të kontrollit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, punëdhënësit i ndërpriten financimi kur bën pushime, pa shkaqe të arsyeshme të punëmarrësve të tjerë jashtë këtij programi.

18. Në zbatim të pikës 7 të vendimit, zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet formularit të personave të punësuar që janë përfitues të pagesës së papunësisë fondet e kursyera nga ai program, të cilat i kalojnë në masën 100% buxhetit të këtij programi.

(Procedurat e kalimit të fondeve përcaktohen në udhëzimin e përbashkët me Ministrin e Financave.)

19. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informacion në lidhje me projektet, ecurinë e tyre, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura etj. Hollësitë përcaktohen në rregulloren e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

20. Në zbatim të pikës 8, kostoja e programit mbulohet nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit për nxitjen e punësimit. Procedurat për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit dhe hollësi të tjera përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Financave.

21. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip, rregullohen me rregulloren metodike të zbatimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS DHE I ÇËSHTJEVE SOCIALE
Engjell Bejtaj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.2118, ka vendosur shpalljen të vdekur të shtetasit Qani Xhemali i datëlindjes 1961 lindur dhe banues në Durrës.

KËRKESE

Zyra e gjendjes civile Shëngjin, Lezhë kërkon të shpallet i vdekur të shtetasi Dashmir Leka i datëlindjes 1970.

KËRKUESE
Marie Nika

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004
--

1. KUSHTETUTA	600
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3. KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4. KODI PENAL	400
5. KODI I PUNËS	500
6. KODI I FAMILJES	450
7. KODI CIVIL	1000
8. KODI RRUGOR	900
9. KODI ZGJEDHOR	355
10. KODI DOGANOR (DISPOZITA ZBATUESE)	1500
11. KODI RRUGOR (DISPOZITA ZBATUESE)	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 30.1.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë